



www.qbz.gov.al

FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2017 – Numri: 10

Tiranë – E enjte, 26 janar 2017

PËRMBAJTJA

	Faqe
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 27, datë 16.1.2017	Për klasifikimin e objekteve sipas qëndrueshmërisë dhe rrezikshmërisë ndaj zjarrit..... 297
Udhëzim i ministrit të Punëve të Brendshme nr. 28, datë 16.1.2017	Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010, të personave me status refugjati ose mbrojtje plotësuese në Republikën e Shqipërisë..... 298
Urdhër i ministrit të Punëve të Jashtme nr. 1, datë 4.1.2017	Për delegim kompetencash për procedurat e prokurimit publik..... 302
Urdhër i ministrit të Punëve të Jashtme nr. 2, datë 4.1.2017	Për delegim kompetencash për procedurat e prokurimit publik..... 302
Urdhër i Gjykatës Kushtetuese nr. 1, datë 9.1.2017	Për delegim kompetencash..... 302
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 339, datë 18.1.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shtesat e varrezave Sharrë”, Tiranë..... 303
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 340/1, datë 19.1.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës “Xoxi Andoni” dhe hapësirave rreth saj”, shtesat, Fier..... 304
Kërkesë e Ministrisë së Zhvillimit Urban nr. 417, datë 20.1.2017	Për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, faza e katërt, Njësia Administrative Portëz, Mbyet, Patos–Fshat”, Fier..... 305

Kërkesë e Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës nr. 357, datë 23.1.2017	Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Plepa–Kavajë–Rrogozhinë (shtesat)”, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”	305
	Korrigjim gabimi material në vendimin nr. 164, datë 6.10.2016, të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e kontratës tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 206/2016, datë 4.11.2016.....	307

UDHËZIM**Nr. 27, datë 16.1.2017****PËR KLASIFIKIMIN E OBJEKTEVE SIPAS
QËNDRUESHMËRISË DHE
RREZIKSHMËRISË NDAJ ZJARRIT**

Në mbështetje të pikës 4, të nenit 102, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të ndryshuar dhe të pikës 2, të nenit 39, të ligjit nr. 152/2015, “Për shërbimin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin”,

UDHËZOJ:

1. Objektet/konstruksionet e ndërtimit sipas shkallës së qëndrueshmërisë ndaj zjarrit dhe rrezikshmërisë ndaj tij ndahen në kategori (klasa), të cilat bazohen në mënyrën e përhapjes së zjarreve në to, sipas klasifikimit të rezistencës së materialeve, që ato kanë në përbërje.

2. Në kuptim të këtij udhëzimi, konsiderohet si një material ndërtimi çdo produkt i prodhuar, me qëllim që të përfshihet në mënyrë të përhershme në punimet e ndërtimit në objekt/konstruksion, produkte që klasifikohen në bazë të reagimit të tyre ndaj zjarrit, të përcaktuara në specifikimet teknike përkatëse, nëse ka, në përputhje me standardet e zbatueshme.

3. Për efekt të kategorizimit sipas qëndrueshmërisë ndaj zjarrit, sipas këtij udhëzimi, termat e mëposhtëm kanë këto kuptime:

a) “material”, konsiderohet një substancë e vetme bazë ose përzierje të substancave të shpërndara në mënyrë uniforme, si metali, guri, druri, betoni, lesh mineral me lidhësit uniforme shpërndarës, apo polimere etj.;

b) “produkt homogjen”, konsiderohet një produkt i përbërë nga një material i vetëm, që ka një dendësi uniforme në të gjithë përbërjen;

c) “produkt johomogjen”, konsiderohet një produkt që përbëhet nga një ose më shumë përbërës, në sasi të konsiderueshme dhe/ose jothelbësore;

d) “komponent thelbësor”, konsiderohet një material që përbën një element të rëndësishëm në përbërjen e një produkti johomogjen, me një sipërfaqe masë për njësi më të madhe se 1.0 kg/m², me një trashësi jo më të vogël se 1.0 mm dhe që është konsideruar të jetë një komponent thelbësor;

e) “komponent jothelbësor”, konsiderohet një material që nuk përbën një pjesë të rëndësishme të

një produkti johomogjen, me një sipërfaqe masë për njësi më të vogël se 10 kg/m², me një trashësi jo më të madhe se 1,0 mm dhe që është konsideruar si një komponent jothelbësor;

f) dy ose më shumë materiale jo të ngjitura “veshje”, pa komponent thelbësor janë një komponent jo i konsiderueshëm, dhe për këtë arsye, duhet të përputhet plotësisht me kërkesat për të qenë një komponent jothelbësor;

g) komponentët jothelbësorë, ndahen në komponentë të brendshëm jothelbësorë dhe komponentë të jashtëm, si më poshtë:

- “komponent i brendshëm jothelbësor”, është një komponent jothelbësor i veshur nga të dyja anët me të paktën një komponent thelbësor;

- “komponent i jashtëm jothelbësor”, është një komponent jothelbësor që në njërin anë nuk është i veshur me një përbërës thelbësor.

4. Kategorizimi sipas qëndrueshmërisë ndaj zjarrit përcaktohet:

a) nga materialet e përdorura në ndërtimin e objektit/konstruksionit të ndërtimit;

b) nga natyra e përdorimit të ndërtesës/strukturës/konstruksionit;

c) madhësia e ndërtesës/strukturës/ konstruksionit;

d) propabiliteti i rënies së zjarrit;

e) nga ngarkesa antizjarr, si dhe vetitë e zjarrit të materialet e ndërtimit.

5. Reagimi i materialeve ndaj zjarrit, sipas shkallës së qëndrueshmërisë, për efekt të këtij kategorizimi, varet nga parametrat e mëposhtëm:

a) ndezshmëria, që nënkupton aftësinë e një materiali për t’u ndezur;

b) shpejtësia e përhapjes së flakës, që nënkupton shpejtësinë me të cilin flaka përhapet në një material;

c) aftësitë shkrirëse, që ka materiali gjatë ekspozimit në një burim ngrohje;

d) prania e zonave inkandeshente, pasi flaka që shuhet, mund të shkaktojë zjarr përsëri;

e) sasia e nxehtësisë që emetohet në njësinë kohore nga një material në gjendjen e djegies;

f) aftësia e materialit të lëshojë grupe të dukshme të grimcave të ngurta dhe/ose të lëngshme pezull në ajër, si rezultat i djegies jo të plotë në kushte të caktuara;

g) prodhimi i substancave të dëmshme, që përkufizohet si aftësia e një materiali të lëshojë gaze dhe/ose avuj në kushte të përcaktuara me djegie.



6. Kategorizimi kryesor në klasa, sipas shkallës së qëndrueshmërisë dhe rrezikshmërisë së materialeve ndaj zjarrit është:

- a) klasa 0, përfshin materiale të padjegshme;
- b) klasa 1, përfshin materiale jo të ndezshme të djegshme;
- c) klasa 2, përfshin materiale të djegshme rezistente ndaj zjarrit;
- d) klasa 3, përfshin materiale djegëse të djegshme;
- e) klasa 4, përfshin materiale lehtësisht të ndezshme të djegshme;
- f) klasa 5, përfshin materiale shumë të ndezshme të djegshme.

7. Parametrat kryesorë për vlerësimin e rezistencës së zjarrit në materialet e konstruksioneve/objekteve ndërtimore, janë:

- a) kapaciteti për të ruajtur forcën mekanike nën veprimin e zjarrit, që identifikohet me simbolin “R”, si dhe ndjekur nga një numër “n” identifikon elementët konstruktiv dhe mban për një kohë të caktuar “n” forcën mekanike të konstruksionit/objektit;
- b) hermeticiteti, aftësia për të mos lejuar kalimin e flakëve, avujve ose gazeve të nxehtë në anën e paeksponuar të konstruksionit/objektit, që identifikohet me simbolin “E”;
- c) izolimi termik, aftësia për të reduktuar transmetimin e nxehtësisë, që identifikohet me simbolin “I”;
- d) “REI” – që identifikon stabilitetin, qëndrueshmërinë, izolimin termik, shprehur në minuta, që një element të ruajë karakteristikat ndërtimore nën ndikimin e zjarrit.

8. Sipas rezistencës së materialeve nga efekti i zjarrit të strukturës/konstruksionit/objektit, klasat përcaktohen në: 10, 15, 20, 30, 45, 60, 90, 120, 180, 240 dhe 360, të cilat shprehin kohën në minuta, gjatë së cilës rezistenca ndaj zjarrit e këtyre materialeve duhet të jetë e garantuar.

9. Shërbimi qendror i MZSH-së dhe ai vendor miraton dokumentacionin teknik të mbrojtjes nga zjarri (projektin e mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimin), të objektit/konstruksionit të ndërtimit, vetëm në përputhje me parametrat kryesorë të vlerësimit të rezistencës të materialeve nga zjarri, si dhe me kategorizimin sipas shkallës së qëndrueshmërisë dhe rrezikshmërisë të tij.

10. Ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e MZSH-së, drejtoritë/sectorët e MZSH-së në bashki për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

UDHËZIM

Nr. 28, datë 16.1.2017

PËR REGJISTRIMIN NË REGJISTRIN KOMBËTAR TË GJENDJES CIVILE (RKGJC) TË VITIT 2010, TË PERSONAVE ME STATUS REFUGJATI OSE MBROJTJE PLOTËSUESE NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Në zbatim të nenit 102, pika 4 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, e ndryshuar, të nenit 29, pika 2, të ligjit nr. 121/2014, “Për azilin në Republikën e Shqipërisë”, nenit 21 dhe nenit 59 të ligjit nr. 10129, “Për gjendjen civile”, të ndryshuar,

UDHËZOJ:

1. Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile (RKGJC) të vitit 2010 të personit me status refugjati apo mbrojtje plotësuese, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile në bashkëpunim me autoritetin përgjegjës për azilin dhe refugjatët paraqet, sa më shpejt të jetë e mundur, nga data e marrjes së lejes së qëndrimit, kërkesë për regjistrimin pranë zyrave të gjendjes civile në njësitë administrative përkatëse.

2. Kërkesa për regjistrim, sipas pikës 1 të këtij udhëzimi, përmban të dhënat personale të personit me status refugjati apo mbrojtje plotësuese, sipas tabelës nr. 1 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

3. Punonjësit e zyrave të gjendjes civile të njërive administrative përkatëse, pas marrjes së kërkesës dhe pas paraqitjes së personit me status refugjati apo mbrojtje plotësuese pranë njësisë së tyre, e regjistrojnë sa më shpejt të jetë e mundur, por jo më vonë se 5 ditëve pune, në regjistrin përkatës.

4. Pas regjistrimit, zyrat e gjendjes civile përkatëse i përcjellin, me postë elektronike dhe me shkresë, brenda 10 ditëve pune, Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile dhe autoritetit përgjegjës për azilin dhe refugjatët, listën e plotë me



numrat e identitetit të personave, sipas tabelës nr. 2 bashkëlidhur këtij udhëzimi.

5. Për regjistrimin e vendbanimit, personi me status refugjati apo mbrojtje plotësuese, paraqet pranë zyrave të gjendjes civile përkatëse, një kopje të lejes e qëndrimit të shoqëruar me një nga dokumentet e mëposhtme:

a) vërtetim të Qendrës Kombëtare Pritëse për Azilkërkues, nëse personi është me qëndrim pranë kësaj qendre;

b) dokument që vërteton pronësinë e pasurisë së paluajtshme apo kontratë qiradhënie/huadhënie/përdorimi, nëse e ka një të tillë;

c) vërtetim vendbanimi të lëshuar nga autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

6. Autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët njofton zyrat e gjendjes civile të njëjësive

administrative përkatëse nëse ka ndryshime në dijeninë e tij, të përbërësve të gjendjes civile, statusit apo vendbanimit në lidhje me këta persona, duke vënë njëkohësisht në dijeni Drejtorinë e Përgjithshme të Gjendjes Civile.

7. Ngarkohet për zbatimin e këtij udhëzimi, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile dhe autoriteti përgjegjës për azilin dhe refugjatët.

8. Urdhri nr. 220, datë 7.7.2010, “Për regjistrimin në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të shtetasve të huaj që kanë përfituar azil në Republikën e Shqipërisë”, shfuqizohet.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË BRENDSHME
Saimir Tahiri

[illegible]

Emër, Mbiemër, Datë, Firmë (specialist në Drejtorinë e Azilit)

[illegible]

BLIK 47
PUN 47

**URDHËR****Nr. 1, datë 4.1.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Punëve të Jashtme, Sekretarit të Përgjithshëm, z. Gazmend Barbullushi, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik është më e madhe se 800,000 (tetëqind mijë) lekë.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data e daljes së këtij urdhri.

3. Sekretari i Përgjithshëm nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

URDHËR**Nr. 2, datë 4.1.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCASH PËR
PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

Mbështetur në nenin 102, pika 4, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 23/2015, “Për shërbimin e jashtëm të RSH-së”, në nenet 22 e vijues të ligjit nr. 44, datë 30.4.2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar dhe vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”,

Faqe | 302

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencës së titullarit të Autoritetit Kontraktor, Ministria e Punëve të Jashtme, drejtorit të Drejtorisë së Çështjeve Juridike dhe Shërbimeve të Brendshme, znj. Etleva Haka, për nënshkrimin e akteve të procedurave të prokurimit, vlera e të cilave, brenda një viti kalendarik është më e vogël se 800,000 (tetëqind mijë) lekë.

2. Këto kompetenca do të ushtrohen nga data e daljes së këtij urdhri.

3. Drejtori i DÇJSHB-së nuk mund t'i nëndelegojë këto kompetenca.

4. Delegimi i kompetencave mbaron me revokimin e aktit të delegimit, si dhe pushimin e ekzistencës së organit delegues apo të deleguar.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI I PUNËVE TË JASHTME
Ditmir Bushati

URDHËR**Nr. 1, datë 9.1.2017****PËR DELEGIM KOMPETENCASH**

Në mbështetje të nenit 27, të ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative të RSH-së”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006, “Për prokurimin publik”, të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Delegimin e kompetencave të titullarit të Autoritetit Kontraktor për Gjykatën Kushtetuese, Sekretarit të Përgjithshëm, zotit Kujtim Osmani.

2. Kompetencat e titullarit të Autoritetit Kontraktor të Gjykatës Kushtetuese do të ushtrohen për periudhën 9.1.2017, deri më 31.12.2017.

3. Ngarkohet me zbatimin e këtij urdhri Sekretari i Përgjithshëm.

4. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Bashkim Dedja



KËRKESË
Nr. 339, datë 18.1.2017

PËR SHPRONËSIM PUBLIK

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Shtesat e varrezave Sharrë”, Tiranë.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Tiranë.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të

Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlllogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 25,670,656 (njëzet e pesë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë mijë e gjashtëqind e pesëdhjetë e gjashtë) lekë.

ZËVENDESMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani

DREJTORIA E PËRGJITHSHME JURIDIKE E ASETEVE DHE LIÇENSIMIT

Llogaritjet paraprake për pasuritë që preken nga projekti " Shtesat e Varrezave Sharrë "

Nr	EMËR ATËSIA MBIEMËR	Z. K.	NR. Pas.	Sip. Përgj. (Arë+Vreshtë ë+Truall) m²	SIP. Prekur Arë m²	SIP. Prekur Vreshtë m²	SIP. Prekur Truall m²	Çmimi për Arë+ Vreshtë Lekë/m²	Çmimi për Truall Lekë/m²	Vlera (Arë+Vreshtë +Truall) Lekë	KONFIRMIM ZVRPP, TIRANË
1	Reshat Kadri Muça	3321	146/3	2100	2100	0		448		940800	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
2	Demir Shit Muça	3321	146/4	1800	1800	0		448		806400	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
3	Ali Shit Muça	3321	146/5	2584	2584	0		448		1157632	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
4	Beram Beqir Muça	3321	146/9	2250	0	2250		448		1008000	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
5	Nezir Beqir Muça	3321	146/7	3010	0	3010		448		1348480	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
6	Qamil Beqir Muça	3321	146/8	2300	0	2300		448		1030400	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
7	Shaban Beram Muça	3321	146/2	1507	1507	0		448		675136	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
8	Harif Vesel Vladi	3321	144/8	2000	2000	0		448		896000	Konfirm. ZVRPP shkresat nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016 dhe nr.prot, 29304/3 dt. 17.11.2016
9	Shtet	3321	146/6	2430	2430	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
10	Shtet	3321	146/1	7125	0	7125		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
11	Shtet	3321	144/4	1924	0	1924		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
12	Shtet	3321	138/2	4375	2495	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
13	Haki Vladi	3321	138/1	1780	0	1361		448		609728	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
14	Nazmi Myslym Vladi	3321	145/2/1	650	650	0		448		291200	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
15	Valjeta Kasa	3321	145/1	650	650	0		448		291200	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
16	Valjeta Kasa	3321	145/2	650	650	0		448		291200	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
17	Shtet	3321	144/9	280	0	280		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresat nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016 dhe nr.prot, 29304/3 dt. 17.11.2016
18	Xhevdet Vladi	3321	144/7	1200	0	1200		448		537600	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
19	Shtet	3321	144/6	1140	0	1140		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
20	Vath Vladi	3321	143/5	650	650	0		448		291200	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
21	B.P. Zeneli, Muça, Meqeneja	3321	143/7	5108	0	0	5108		2560	13076480	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/3 dt. 17.11.2016
22	Nuk ka informacion nga ZVRPP	3321	145/3	0	0	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
23	Shtet	3321	144/9	335	0	335		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresat nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016 dhe nr.prot, 29304/3 dt. 17.11.2016
24	Nuk ka informacion nga ZVRPP	3321	121		0	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
25	Nuk ka informacion nga ZVRPP	3321	171/1		0	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
26	Nuk ka informacion nga ZVRPP	3321	171/2		0	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
27	Nuk ka informacion nga ZVRPP	3321	171/3		0	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
28	Nuk ka informacion nga ZVRPP	3321	147		0	0		0		0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/1 dt. 24.10.2016
29	Shtet (Rugë)	3321	1371	13900	0	0	2372	0	0	0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/3 dt. 17.11.2016
30	Vath Daut Vladi	3321	144/8	2950	2950	0		448		1321600	Konfirm. ZVRPP shkresa nr.prot, 29304/3 dt. 17.11.2016



31	Rustem Fadil Vladi	3321	145/1/1	650	650	0	448	291200	Konfirm. ZVRPP shkresa nr. prot. 29304/3 dt. 17.11.2016
32	Pa emër (tek përsh. i veçnitë përdorues Maliq Muça)	3321	144/1	1800	0	1800	448	806400	Konfirm. ZVRPP shkresa nr. prot. 29304/3 dt. 17.11.2016
33	Shtet (Varreza)	3321	124	32300	288	0	0	0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr. prot. 29304/3 dt. 17.11.2016
34	Shtet (Varreza)	3321	142/1		1131	0	0	0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr. prot. 29304/3 dt. 17.11.2016
35	Shtet	3321	143/9	2235	1090	0	0	0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr. prot. 29304/3 dt. 17.11.2016
36	Shtet (Kanal)	3321	362	26900	521	0	0	0	Konfirm. ZVRPP shkresa nr. prot. 29304/3 dt. 17.11.2016
SHUMA				24146	22725	7480		26670656	

SHËNIM:

1. Për pasuritë e llojit arë, vreshtë dhe truall, çmimi për llogaritje është bazuar në VKM 89, dt. 03.02.2016.
2. Pasuritë e prekura nga projekti, konfirmohen nga ZVRPP, Tiranë, me shkresat nr. prot. 29304/1, dt. 24.10.2016 dhe nr. prot. 29304/3, dt. 17.11.2016
3. Pasuritë nr. 145/3, 121, 171/1, 171/2, 171/3, 147, zk. 3321, janë konfirmuar pa informacion nga ZVRPP, shkresa nr. prot. 29304/1, dt. 24.10.2016
4. Pasuritë nr. 127/24 dhe 141/8, zk. 3321, nuk janë të përfshira në zonën objekt të kërkuara, konfirmuar nga ZVRPP, shkresa nr. prot. 29304/3, dt. 17.11.2016

KËRKESË**Nr. 340/1, datë 19.1.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Rehabilitimi i rrugës “Xoxi Andoni” dhe hapësirave rreth saj”, shitesat, Fier.

Subjekti kërkuar i këtij objekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të

Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 26,492,996 (njëzet e gjashtë milionë e katërqind e nëntëdhjetë e dy mijë e nëntëqind e nëntëdhjetë e gjashtë) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Gjon Radovani**

VLERESIME PARAPRAKE PER PASURITE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTEVE PER INTERES PUBLIK

Lista emërore e pronarëve, pasuritë shtese e të cilëve do të shpronësohen për realizimin e projektit “Rehabilitimi i rrugës Xoxi Andoni dhe hapësirave rreth saj”, Fier

Nr.	Emër Mbiemër	Zona Kadastrale	Nr. Pasurisë	Sip. Përgj. Truallit (m ²)	Sip. Prekur Truallit (m ²)	Çmimi për truallin (leke / m ²)	Vlera e truallit (leke)	Sip. Totale Nderteses me certifikate (m ²)	Sip. Prekur Nderteses (m ²)	Amortizimi (%)	Vlera e Nderteses me preventiv (leke)	Vlera e Përgjith. (leke)	Gjendja juridike e pasurisë
1	Anastas Andon Gjata	8534	3/459	234.40	24.65	12,893	317,812	229.00	17.05	5%	663,110	980,922	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
2	Safet Qenan Troka	8534	3/468	50.00	50.00	12,893	644,650	-	-	-	-	644,650	Inskriptuar 2 herë në favor të Luan Toska dhe Bledar Toska.
3	Agron Sulejman Xhafa + bashkepronare	8534	3/33	1,627.00	1627.00	12,893	20,976,911	-	-	-	-	20,976,911	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
4	Imer Ismail Osmenaj	8534	3/65 - N2	-	-	-	-	43.60	43.60	20%	699,138	699,138	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
5	Hena Halim Rizaj	8534	3/65 - N5	15.90	15.90	12,893	204,999	31.80	31.80	30%	446,182	651,181	Plotesim dokumentacioni në lidhje me truallin
6	Flamur Myrdar Kondi	8534	3/290	60.00	60.00	12,893	773,580	33.00	33.00	5%	1,766,614	2,540,194	Inskriptuar në favor të Fondit Besa sh.a.
Vlera Totale												26,492,996	

Vlerësimi është bërë duke zbatuar VKM nr.138 date 23.03.2000 "Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive prone private që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë për interes publik" dhe VKM nr. 89 date 03.02.2016 "Për miratimin e hartës së vlerësimit të tokës në Republikën e Shqipërisë"

**KËRKESË****Nr. 417, datë 20.1.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Zhvillimit Urban shpall kërkesën për shpronësim, për interes publik, të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga realizimi i projektit “Zgjerimi i varrezave publike, faza e katërt, Njësia Administrative Portëz, Mbyet, Patos–Fshat”, Fier.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Bashkia Fier.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Vlera totale e shpronësimit është 7,464,000 (shtatë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e katër) lekë.

**ZËVENDËSMINISTRI I
ZHVILLIMIT URBAN
Alfred Dalipi**

VLERESIME PARAPRAKE PER PASURITE PRONE PRIVATE QE DO TE SHPRONESOHEN PER EFEKT TE REALIZIMIT TE PROJEKTEVE PER INTERES PUBLIK

Lista emërore e pronareve, pasurite e të cilëve do të shpronësohen për realizimin e projektit “Zgjerimi i Varrezave publike , faza e IV, Fier , dhe Njesia Administrative Portez

Nr.	Emer Mbiemer	Zona Kadastrale	Nr. Pasurise	Sip. Pergj. Toke/Are (m ²)	Sip. Prekur Toke /Are (m ²)	Cmimi per truallin (leke / m ²)	Vlera e truallit (leke)	Vlera e Pergjith. (leke)	Gjendja juridike e pasurise
1	Ibrush Riza Hoxha	2637	288/142	3117	3117	1,000	3,117,000	3,117,000	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
2	Mylazim Riza hoxha	2637	288/117	3467	3467	1,000	3,467,000	3,467,000	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
3	Mynyr Veli Beqiraj	2891	392/31	2,000	2000	440	880,000	880,000	Konfirmim nga Z.V.R.P.P
								7,464,000	

Vleresimi paraprak eshte bere duke u bazuar ne VKM Nr.873, date 14/12/2011 "Per shpronësimin per interes publik, per pasurite prone private qe preken nga zgjerimi i varrezave publike faza e III " ne Bashkine Fier dhe VKM nr. 514, date 30/07/2014 "Mbi miratimin e vleres se prones per secilin Qark ne Republiken e Shqiperise , mbi bazen e te cilit eshte miratuar VKB. Nr.9, date 20/01/2016 .

KËRKESË**Nr. 357, datë 23.1.2017****PËR SHPRONËSIM PUBLIK**

Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës shpall kërkesën “Për shpronësimet, për interes publik, të pasurive pronë private që preken nga ndërtimi i segmentit rrugor “By-Pass Plepa–Kavajë–Rrogozhinë (shesat)”, për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”.

Subjekti kërkues i këtij objekti është Autoriteti Rrugor Shqiptar.

Me anë të këtij publikimi kërkojmë të vëmë në dijeni personat, të cilët preken nga ky shpronësim, që konsiston në masën e vlerësimit të llogaritur në

bazë të vendimit nr. 138, datë 23.3.2000, të Këshillit të Ministrave, “Për kriteret teknike të vlerësimit dhe të përlogaritjes së masës së shpërblimit të pasurive që shpronësohen, të pasurive që zhvlerësohen dhe të të drejtave të personave të tretë, për interes publik”, të ndryshuar, për pronarët sipas listës emërore bashkëlidhur.

Pronarët që kanë emrin në listën emërore dhe personat e tretë, brenda 15 ditëve nga plotësimi i këtij afati për publikim, kanë të drejtë të paraqesin pretendimet e tyre lidhur me çmimin, sipërfaqen, titullin e pronësisë apo llojin e pasurisë që kanë në pronësi, të shoqëruara me dokumentet përkatëse në ministrinë kompetente (Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës).



Ky publikim bëhet për pasuritë e llojit “arë” dhe “truall”. Pronarët do të kompensohen, për efekt shpronësimi, pas miratimit të kërkesës për shpronësim nga Këshilli i Ministrave dhe pasi të kenë paraqitur dokumentacionin respektiv të pronësisë pranë Autoritetit Rrugor Shqiptar (subjekti kërkuar në bazë të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, “Për shpronësimin dhe marrjen në përdorim të përkohshëm, të pasurisë pronë private për interes publik”.

Vlera totale e shpronësimit është 1,953,153 (një milion e nëntëqind e pesëdhjetë e tre mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë.

ZËVENDËSMINISTRI I TRANSPORTIT
DHE INFRASTRUKTURËS

Bahri Shaqiri

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR
SEKTORI I SHPRONËSIMEVE

Lista e pronarëve që shpronësohen nga ndërtimi i segmentit rrugor "By-Pass Plepa-Kavajë-Rrogozhinë (shtesa)"

Nr.	Pronari			Z.k.	Nr.pasurisë	Lloji i pasurisë	Sip.totale (m2)	Sip. e shpronësimit (m2)	Çmimi (lekë/m2)	Vlera totale (lekë)	Shënime
	Emri	Atësia	Mbiemri								
1	Ylli	Faik	Harizi	1932	160.2	Arë	4000	37	329	12173	Certifikatë pronësie
2	Zabit	Bajram	Harizi	1932	160.3	Arë	4340	43	329	14147	Certifikatë pronësie
3	Haki Dik	Bajram	Harizi	1932	160.4	Arë	4413	45	329	14805	Certifikatë pronësie
4	Kujtim	Hysni	Kashari	1932	160/5	Arë	4530	50	329	16450	Certifikatë pronësie
5	Xhevdet	Hysni	Kashari	1932	160/6	Arë	4520	48	329	15792	Certifikatë pronësie
6	Hysni	Faik	Beu	1932	160/9	Arë	5000	51	329	16779	Certifikatë pronësie
7	Zija		Harizaj	1932	160.26	Arë	3370	76	329	25004	Certifikatë pronësie
8	Mahmude Ardian Donika Silvana		Harizi Harizi Tosku (Harizi) Memolla (Harizi)	1932	160.27	Arë	5978	123	329	40467	Certifikatë pronësie
9	Hekuran	Fer	Harizi	1932	160/28	Arë	2980	41	329	13489	Certifikatë pronësie
10	Haziz	Aqif	Beu	1932	78/17	Arë	1000	140	329	46060	Certifikatë pronësie
11	Haziz	Aqif	Beu	1932	115/10	Arë	4200	1003	329	329987	Certifikatë pronësie
12	Ymer	Tahir	Dakolli	1932	72.5	Truall	1000	70	330	23100	Certifikatë pronësie
13	Gezim Irma Kadrije Vitjona	Adem Adem Mustafa Adem	Hidri	2140	242/20.1	Arë	272	264	329	86856	Certifikatë pronësie
14	Gezim Irma Kadrije Vitjona	Adem Adem Mustafa Adem	Hidri	2140	242/20.2	Arë	1270	1109	329	364861	Certifikatë pronësie
15	Xhevat	Hajdar	Saraçi	2140	242.21/5	Arë	5237	293	329	96397	Certifikatë pronësie
16	Alan Algert Englantina Flamur Lorenc Xhevrije	Algert Flamur Haxhi Hajdar Flamur Flamur	Saraçi	2140	242/22.1	Arë	5214	312	329	102648	Certifikatë pronësie
17	Qerim	Harun	Shehi	2140	242/24.6		690	607	329	199703	Certifikatë pronësie
18	Rrapush	Hekuran	Saraçi	1814	195/12	Arë	7001	878	312	273936	Konfirmuar nga ZVRPP
19	Rexhep		Kalo	1814	195/35		2178	49	312	15288	Konfirmuar nga ZVRPP
20	Agim	Mehmet	Uku	2399	195/2	Arë	2000	172	329	56588	Certifikatë pronësie
21	Sybe		Mema	2399	77/8		4000	99	329	32571	Proces konfirmimi
22	Shaqir	Imer	Kollçaku	8552	1.279	Arë	167	130	345	44850	Certifikatë pronësie
23	Sherbet	Xhaferr	Murrani	1815	261.49	Arë	1000	338	329	111202	Certifikatë pronësie
SHUMA TOTALE								5978		1953153	



KORRIGJIM GABIMI MATERIAL

Në vendimin nr. 164, datë 6.10.2016, të Bordit të ERE-s “Mbi miratimin e kontratës tip për verifikimin dhe vulosjen e matësve elektrikë”, botuar në Fletoren Zyrtare nr. 206/2016, datë 4.11.2016, bëhet zëvendësimi i gabimeve materiale si më poshtë:

1. Në kapitullin III:

Pika 3.1, në fund të fjalisë shtohet: “ose në terren”.

Pika 3.5, pas fjalës energjisë, shtohet: “elektrike pranë laboratorit të personit juridik të autorizuar ose në terren”.

2. Në kapitullin V:

Pika 5.1, hiqet: “personi juridik i autorizuar për këtë qëllim, akreditohet sipas legjislacionit në fuqi”.

Pika 5.5, zëvendësohet “përputhshmërinë e klasës së tyre” me “konformiteti”.

3. Në kapitullin VI:

Pika 6.3, hiqet “i cili akreditohet konform legjislacionit në fuqi si laborator testues me Standardin S SH EN ISO/IEC 17025”.

Pika 6.6, hiqet “vlera 0.5 dhe C”.

Pika 6.8, hiqet “klasa 0.5/GML=+/- 0.5%” dhe “klasa C/GML=+/- 0.5%”

4. Në kapitullin VIII:

pika 8.1, hiqet “të cilët akreditohen konform legjislacionit në fuqi si laborator testues me Standardin S SH EN ISO/IEC 17025”.

5. Në kapitullin XI:

Pika 11.9, shtohet në fund pika “boksi individual i matësit (operatori i rrjetit)”.

6. Në kapitullin XII:

Pika 12.1, në paragrafin e parë, pas fjalës në bashkëpunim shtohet: “dhe miratim nga”.

Në pikën 12.2.3, togfjalëshi “klientët që paraqesin dyshime”, vendoset zëvendësohet me “periodik”.

Në pikën 12.2.18, hiqet fjala “drejtori”.

Në pikën 12.2.18, “jo më vonë se 1 ditë”, bëhet “jo më vonë se 2 ditë”.

7. Në kapitullin XVIII:

Pika 18.4, hiqet “me inspektimin e rregullshmërisë së lidhjeve elektrike të matësit elektrik te klienti dhe inspektime të tjera sipas pikës 9.7 si”.

8. Në kapitullin XXI:

Pika 21.1,

ishte: “Palët janë përgjegjëse për zbatimin e planit vjetor të shërbimeve objekt i kësaj kontrate, i përgatitur nga DPM-ja dhe Operatori i Rrjetit, në bashkëpunim me subjektin e autorizuar”,

bëhet: “Palët janë përgjegjëse për zbatimin e planit vjetor të shërbimeve objekt i kësaj kontrate, i përgatitur dhe i miratuar nga DPM-ja, në bashkëpunim me Operatorin e Rrjetit dhe subjektin e autorizuar”.

9. Në kapitullin V:

Pika 5.5, germa “i”, në kapitullin VII, pika 8.7, në kapitullin XIX, pika 19.3, në kapitullin XXI, pika 21.4, hiqet fjala “e akredituara”.

10. Titulli i aneksit 26, bëhet “Plani i punës vjetor, i miratuar nga DPM-ja, për shërbimet sipas rajoneve”.

	Formati 61x86/8
--	-----------------

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2017

Adresa:
Bulevardi “Gjergj Fishta”
pas ish-Ekspozitës “Shqipëria Sot”
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 112 lekë